



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 822 / Prot.

Tiranë, më 20 /09/2016

VENDIM

Nr. 61, datë 20 / 9 /2016

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi/ Qendra "Res Publica", përfaqësuar nga Av. ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesën nr. 822 Prot., datë 27.07.2016, ndaj Autoritetit Publik/ Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza" me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumentave zyrtare".

Ankuesi në cilësinë e kërkuarit, me shkresën e datës 15.07.2016 ka kërkuar nga Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" t'i vihet në dispozicion *informacioni si më poshtë*:

1. *Kopje të Raportit Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza", "Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomike financiare dhe vlerësuese", për periudhën 01.01.2011-31.12.2012.*
2. *Një kopje të të gjitha informacioneve të mëvonshme që Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", ka raportuar në KLSH për përmbushjen e detyrave që i janë lënë sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit të sipërpërmendur.*

Me shkresën nr. 3772/1 Prot, datë 20.07.2016. Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" i ka kthyer përgjigje kërkuarit duke refuzuar dhënie të informacionit me arsyetimin "...se të dhënat e kërkuara nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara në dispozitat e nenit 17, të Ligjit 119/2014 "Për të drejtën e informimit".

Pas refuzimit të dhënies së informacionit ankuesi pretendon se është cënuar në të drejtën për informim, pasi përgjigja e Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza" nuk është e mbështetur në ligj për arsyet se: "Informacioni i kërkuar nuk përbën asnjë nga rastet e kufizimit të përfshira në nenin 17 të Ligjit 119/2014 "Për të drejtën e informimit".

Në këto kushte ankuesi Qendra "Res Publica" kërkon nga KDIMP, ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit si dhe urdhërimin e dhënies së informacionit/dokumentacionit nga autoriteti publik.

Zyra e Komisionerit, pas shqyrtimit të ankesës si dhe pas konsultimit të legjislacionit, vlerëson se informacioni i kërkuar nga Qendra "Res Publica" është informacion publik. Në kuptim të nenit 2 pika 2 e Ligjit 119/2014, informacion publik është çdo e dhënë e regjistruar

në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik.

Informacioni mbi raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit është informacion publik dhe dhënia e tij nuk mund të refuzohet. Çdo autoritet publik, në kuptim të nenit 7, pika dh) të Ligjit 119/2014, duhet të ketë publik në programin e transparencës mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga KLSH ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit.

Në këto kushte, në lidhje me ankesën e Qendrës "Res Publica" ndaj Autoritetit Publik/ Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Komisioneri vlerëson se ankesa është e bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr.119/2014 'Për të drejtën e informimit', shkronjën a) të pikës I të nenit 18 të ligjit nr 49/2012 'Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative',

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës së Qendrës "Res Publica", Nr. 822 Prot., datë 27.07.2016, ndaj Autoritetit Publik/ Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare".
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik/ Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar (Kopje të Raportit Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza", "Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomike financiare dhe vlerësuese", për periudhën 01.01.2011-31.12.2012), si edhe (Një kopje të të gjitha informacioneve të mëvonshme që Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", ka raportuar në KLSH për përmirësimin e detyrave që i janë lënë sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit të sipërpërmendur) brenda datës 27.09.2016.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.
4. Ky vendim u dha sot në datë 20.9.2016.

